



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Rev.nr.340/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.sc. Muhamet Rexha, kryetar, Rrustem Thaqi dhe Nenad Laziq anëtarë, në çështjen juridike të paditësit F. B. nga fshati ..., Komuna e V., të cilin e përfaqëson avokati Agim Lushta nga M., kundër të paditurit I.K. nga fshati ..., Komuna e P., të cilin e përfaqëson avokati Xhafer Maliqi nga P., për shkak të kthimit të kaparit të dyfishuar, duke vendosur sipas revizionit të paditësit paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.7030/21 datë 11.04.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 5.09.2024, mori këtë,

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pathemeltë revizioni i paditësit F. B. nga fshati ..., Komuna e Vushtrrisë, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.7030/21 datë 11.04.2024.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.7030/21 dt.11.04.2024 është refuzuar si e pa themeltë ankesa e paditësit dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega në Vushtrri C.nr.107/20 dt.10.06.2021, me të cilin, me pjesën e I të dispozitivit të tij, refuzohet kërkesëpadia e paditësit F. B. nga fshati ..., Komuna e V., kundër të paditurit I. K., nga fshati ..., Komuna e P., me të cilën ka kërkuar kthimin e kaparit të dyfishuar në lartësi prej 10,000.00 euro, si e pa bazuar. Me pjesën e II të dispozitivit detyrohet paditësi që të paditurit të ia

paguajë shpenzimet e procedurës në shumë prej 540.80-euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, në afat ligjor paditësi ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet revizioni, dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe ai i gjykatës së shkallës së dytë të anulohen dhe çështjen ta kthen për rigjykim gjyqtarëve të njëjtë apo të tjerë të gjykatës së shkallës së parë apo të dytë.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në kuptim të dispozitës së nenit 215 të LPK-së dhe shkresave të lëndës, si dhe pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në revizion ka gjetur se:

Revizioni i paditësit është i pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi ka paraqitur padi kundër të paditurit, atëherë në Gjykatën Komunale në Vushtrri, më datë 15.03.2004, të cilën e ka precizuar me parashtresën e dt. 1.09.2016, me të cilën ka kërkuar kthimin e kaparit të dyfishuar në shumë prej 10,000.00 euro, me të dhënat tjera si në padi dhe petitumin e saj, përkatësisht, si në precizimin e saj. Më datën 18.11.1998, shitësi, këtu i padituri I.K., me blerësin, fillimisht me paditësin, tani i ndjeri H. B., babai i këtu paditësit F. B., kishin lidhur Kontratë private (interne) për shitblerjen e pasurisë së paluajtshme (me të dhënat si në pikën I të kontratës), të pa vërtetuar në organin kompetent apo në gjykatë. Nga të gjitha provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe të administruara nga gjykata e shkallës së parë, nuk u vërtetua se paraardhësi i paditësit F. B., H. B., dhe i padituri I. K., kanë kontraktuar shprehimisht në kontratën inerne / private të dt.18.11.1998, kaparin në lartësi prej 10,000.00 DM, e cila kontratë, pra, si e tillë, ishte e pa vlefshme juridikisht, e që kishte të bënte me shitblerjen e ngastrës kadastrale nr.8..., në vendin e quajtur “Qytet”, me kulturë shtëpi dhe oborr dhe ndërtesë me një sipërfaqe prej 0.03,46 ha, e cila evidentohet në Fletën poseduese nr..., për ZK- V. Dëshmitarët R. M. dhe L. B., kanë deklaruar se vetëm verbalisht palët janë pajtuar që paraardhësi i paditësit të ia jep në emër të kaparit të paditurit shumën prej 10,000-DM. Ndërsa, dëshmitari tjetër, U. K., deklaroi se shumën prej 10,000-DM, paraardhësi i paditësit F. B., H.B., ia ka dhënë të paditurit I. K., në emër të pagesës së një pjese të çmimit të shitblerjes së tërësishme në çmimin siç ka thënë ai sa më kujtohet prej 80,000-DM. Këto deklarata të dëshmitarëve ishin

kontradiktore njëra me tjetrën dhe nuk vërtetuan se midis të lartë përmendurve ka qenë shprehimisht i kontraktuar kapari të cilin e kërkon tani paditësi F., siç parashihet shprehimisht me nenin 80 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (të v.1978, i cili ishte në fuqi atëherë) dhe përveç kësaj, del se kapari në asnjë pikë të kontratës së lartë cekur të dt.18.11.1998, (e pa vërtetuar në gjykatë) nuk është paraparë dhe çështja e pagesës së kaparit nuk përmendet fare në asnjë pikë të saj. Përkundrazi në pikën I të kësaj kontrate është shkruar shprehimisht se H. B. “ në emër të çmimit për shtëpi ja paguajti në dorë shitësit I.K. shumën prej 10.000-DM ”, kjo d.m.th. se shuma e paguar si më lartë, është paguar në emër të përmbushjes së kontratës, e jo siç pretendohet nga pala paditëse në emër të kaparit.

Duke u nisur nga gjendja e këtyre faktike, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit për pagesën e shumës së sipër përmendur, në emër të kaparit të dyfishuar, është e pabazuar, ndaj, nga arsyet e sipër cekura, e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka vendosur si në pjesën I dhe II të dispozitivit të aktgjyqimit të saj.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore ka gjetur se janë të pabazuara pretendimet ankimore të paditësit lidhur me kërkesën për pagesën e shumës si në dispozitivin e aktgjyqimit të gjykatës së shkallës së parë. Për këtë ajo ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, ka dhënë arsyet e mjaftueshme, ka zbatuar drejtë dispozitat procedurale të LPK-së dhe të drejtën materiale , kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar, ndaj, e ka refuzuar ankesën e paditësit dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, konsideron se aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët, janë marrë me zbatimin e drejtë të dispozitave të procedurës kontestimore dhe të së drejtës materiale, përmbajnë arsye të mjaftueshme për faktet relevante të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë. Aktgjykimi i goditur nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat kjo gjykatë i vlerëson në kuptim të nenit 215 të LPK-së, sipas detyrës zyrtare.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, konsideron se në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë drejtë e kanë zbatuar të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar. Gjykata Supreme e Kosovës, i vlerëson si të pabazuara thëniet e revizionit që kanë të bëjnë edhe me

zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, nga se gjykatat e instancës më të ulët drejt kanë vlerësuar dhe kanë zbatuar të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit për pagesën e shumës së kërkuar, nga arsyet e sipër cekura, është e pa bazuar, sepse, me provat e administruara nuk janë vërtetuar bindshëm faktet me të cilat do të vërtetohej baza e kërkesëpadisë për pagesën e shumës së kërkuar në emër të kaparit të dyfishuar, nga se në këtë drejtim pala paditëse nuk ka prezentuar prova relevante me të cilat gjykata do të vërtetonte bazën, por, edhe lartësinë e kërkesëpadisë. Kur jemi këtu, duhet theksuar se, është obligim i secilës palë ndërgjyqëse të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta (neni 319.1 i LPK-së), kurse, në bazë të dispozitave të nenit 322.1 dhe 2 të LPK-së, barra e të provuarit i takon paditësit. Gjykata, drejtë ka vlerësuar se me provat e prezantuara nga paditësi dhe të administruara nga gjykata nuk janë vërtetuar bindshëm faktet për bazueshmërinë e kërkesëpadisë që kanë të bëjnë me pagesën e shumës së kërkuar si dhe detyrimin e të paditurit për pagesën e kaparit të dyfishuar, ndaj, rezulton se në rastin konkret civil juridik nuk mund të zbatohen dispozitat e nenit 79 dhe nenit 80 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (1978), që kanë të bëjnë me kaparin. Dispozitat e nenit 79 dhe ato të nenit 80 të LMD-së, mbi kthimin dhe llogaritjen e kaparit, mund të prodhojnë efekte juridike, vetëm nëse kontrata themelore (bazë) përmbush formën e përcaktuar ligjore, gjë që, siç u sipër theksua, këtu nuk është rast. Kapari, veç tjerash, sipas ligjit është mjet i sigurimit të ekzekutimit të kontratës, por, sikundër u theksua më lartë, ai nuk është kontraktuar si klauzolë e veçantë në kontratën kryesore të shitblerjes, të sipër përmendur, dhe as në kontratë të veçantë, nga këtu, kjo Gjykatë, konsideron se, pala paditëse, apo pala e interesuar, nën konditat përkatëse ligjore, mund të kërkojë kthimin e asaj që ka dhënë etj, por jo edhe kaparin e dyfishuar.

Gjykata Supreme e Kosovës i vlerësoi thëniet e paditësit në revizion se aktgjykimi i goditur është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore , për arsye se është dhënë pa vlerësim ligjor të pretendimeve ankimore, por gjeti se të njëjtat janë të pa bazuara sepse gjykata e shkallës së dytë e ka bërë vlerësimin e thënieve të ankesës që kanë qenë me rëndësi vendimtare për dhënien e vendimit të saj në kuptim të nenit 204 të LPK-së, sipas së cilës dispozitë është përcaktuar se: në arsyetimin e aktgjykimit, gjegjësisht aktvendimit , gjykata e shkallës së dytë duhet t'i vlerësoi thëniet në ankesë që kanë qenë të rëndësisë vendimtare për dhënien e vendimit të saj, siç edhe ka vepruar ajo gjykatë duke dhënë arsyet për faktet vendimtare për marrjen e një vendimi të tillë. Në kontekstin e sipër përmendur, po ashtu, rezulton se gjykata e instancës më të ulët, lidhur me rastin konkret, ka vepruar në pajtim me nenin 2.1 të LPK-së, me të cilin

parashihet se “ Në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse ”. Prandaj, nga këtu, Gjkata Supreme e Kosovës i vlerëson si të pa bazuara pretendimet e revizionit për shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore dhe për zbatimin e gabuar të së drejtës materiale.

Nga të lartcekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.340/2024 datë 5.09. 2024

Kryetar i kolegjit,
Mr.sc. Muhamet Rexha